

HAMIT KABA

**POLITIKA E SHBA NDAJ SHQIPËRISË NË VITET 70
DHE REFLEKTIMI I SAJ NË NATO**

Politika e Niksonit pas ardhjes së tij në Shtëpinë e Bardhë në vitin 1969 shënoi fundin e strategjisë së “Përmbajtjes” dhe fillimin e “Realpolitikës”. Politika e re e SHBA u zbatua edhe në marrëdhëniet me Shqipërinë. Në fillim të viteve ‘70 SHBA morën të parët iniciativën për të rivendosur marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë, pas një ngërçi më shumë se një çerekshekulli të marrëdhënieve dypalëshe. Iniciativa e amerikanëve nuk erdhi si rezultat i ndryshimeve apo zbutjes së regjimit komunist në Shqipëri, por ajo ishte pjesë e vizionit të ri politik të SHBA për të pranuar një realitet të caktuar në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe veçanërisht në raportet me vendet socialiste të Evropës Lindore. Duhet pranuar se, iniciativën për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike me SHBA, që nga fundi i vitit 1944, e kishin pasur qeveritë shqiptare, ndërsa në fillim të viteve ‘70 dhe në dekadat pasardhëse ajo u ndërmor nga administratat amerikane. Marrëdhëniet shqiptaro-amerikane në vitet 70-80, kanë disa momente të rëndësishme, ndër të cilat do të veçoja propozimet amerikane për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë në fillim të viteve 70, periudha e ndarjes shqiptaro-kineze, dhe së fundi vdekjen e Enver Hoxhës dhe rënien e regjimit komunist në Shqipëri.

Për më shumë se dy dekada, politika e jashtme e SHBA kishte funksionuar mbi bazën e strategjisë së “Përmbajtjes”- politikë, e cila nga fundi i viteve ‘60 dukej se e kishte konsumuar veten. Ajo u zëvendësua nga “Realpolitika”, arkitekt i së cilës ishte presidenti Nikson. Ndryshimet ishin bërë të domosdoshme, sepse “strategjia e përmbajtjes” e kishte futur Amerikën në vijën e parë të çdo krize ndërkombëtare; retorika e lartë e periudhës së Kenedit kishte përcaktuar objektiva që ishin përtej

kapaciteteve fizike dhe emocionale të Amerikës”¹. Nëpërmjet politikës së “përmbajtjes” amerikanët nuk kishin synuar të vendosnin ekuilibrin e forcës, por të ndryshonin shoqërinë sovjetike, dhe përderisa BS ruante ideologjinë e tij, bisedimet me të konsideroheshin të pakuptimta. Niksoni u nda nga baballarët e “përmbajtjes” dhe zgjodhi një rrugë që të kujtonte Çurçillin, i cili pas vdekjes së Stalinit, bëri thirrje për bisedime me Moskën. “Niksoni, besonte se procesi i bisedimeve dhe një periudhë e gjatë gare paqësore do ta shpejtonin transformimin e sistemit sovjetik dhe do të forconin demokracitë”². Tendencë për ndryshime në politikën amerikane në trajtën e saj virtuale ishte shfaqur para ardhjes së Niksonit në Shtëpinë e Bardhë. Në vitin 1964 në një studim të Këshillit të Planifikimit të Politikave theksohej: “Ne duam të “ndërtojmë ura” me Evropën Lindore, me qëllim që të lehtësojmë dhe mbështesim ndryshimet konstruktive, me mendimin për të përparuar drejt ribashkimit të Evropës Lindore me Perëndimin. Ribashkimi nuk kuptonte një entitet politik, aleancë ushtarake apo forcë të tretë. Ai nënkuptonte lidhje më të afërta bilaterale, kontrollin e armëve dhe marrëdhënie shumë paleshe. Kjo ishte për Shtetet e Bashkuara një mundësi tërheqëse dhe domosdoshmëri mbrojtëse.”³ Nevojën e ndryshimeve të thella në politikën e jashtme të SHBA e kishte nënvizuar Niksoni që në vitin 1967, në një artikull të botuar prej tij në revistën “Foreign Affairs magazine”, kur ai ende nuk ishte ngjitur në fronin e Shtëpisë së Bardhë. Sidoqoftë ajo u shndërrua në një politikë funksionale vetëm pasi ai erdhi në krye të saj.

Politika e Niksonit në fakt nuk bëri gjë tjetër veçse njohu dhe pranoi disa realitete të reja në marrëdhëniet ndërkombëtare, të cilat ishin të domosdoshme të merreshin në konsideratë. Marrëdhëniet brenda trekëndëshit: SHBA, BRSS dhe Kina i hapën rrugën një numri arritjesh të mëdha, të tilla, si: dhënia fund e luftës së Vietnamit; marrëveshjen që garanoi hyrjen e forcave perëndimore në Berlinin e ndarë; pakësimin dramatik të influencës sovjetike në Lindjen e Mesme; mbajtjes së Konferencës për Sigurimin dhe Bashkëpunimin në Evropë; bisedimeve për kufizimin e armëve atomike; pranimin e Kinës në Kombet e

¹ Henry Kissinger, *Diplomacia*, Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, Tiranë, 1999, f. 707.

² *Po aty*, f. 713.

³ *National Archives and Record Administration* (më tej: *NARA*), RG 59, *Ndërtimi i urave në Evropën Lindore*, 31 korrik 1964.

Bashkuara. Këto ndryshime ndodhën në administratën e Niksonit, dhe më tej ato u vazhduan nga presidenti Ford.

Propozimet e para, të druajtura dhe jo të drejtpërdrejta, të SHBA për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë duhen kërkuar në raportet vjetore kushtuar marrëdhënieve të SHBA me vendet e Evropës Lindore në vitet 1970- 1972, të paraqitura nga Sekretari Amerikan i Shtetit Roxhers. Në raportin e vitit 1971 Roxhers do të përmendte se SHBA e konsideronin të mirëpritur procesin e intensifikimit të normalizimit të marrëdhënieve të Shqipërisë me vendet e tjera, si një zhvillim që do t'i kontribuonte stabilitetit dhe paqes në rajon⁴. Një tjetër propozim por në trajtë të qartë dhe më të plotë do të paraqitej prej Ndihmësekretarit amerikan të Shtetit Kenneth Rush, në fjalimin e mbajtur më 4 prill 1973 në akademinë Annapolis. Në paragrafin kushtuar Shqipërisë, Kenneth Rush do të theksonte se “vetëm Shqipëria nuk kishte bërë ndonjë progres të dukshëm, por nëse ajo dëshiron të rivendosë marrëdhëniet, do ti gjejë Shtetet e Bashkuara të përgatitura për t’ju përgjigjur”⁵. Koha e zgjedhur për të t’i propozuar Shqipërisë rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike ishte e favorshme, së pari, Shqipëria ishte tërhequr nga Traktati i Varshavës dhe figuronte juridikisht e paangazhuar në dy blloqet ushtarake më të mëdha të kohës. Por mendohej se ajo ishte e ekspozuar nga ndonjë sulm i mundshëm i BS dhe aleatëve të tij. Së dyti, Afrimi amerikano-kinez mund të ndikonte edhe në “shkrirjen e akujve” ndërmjet Shqipërisë dhe SHBA. Dokumentacioni arkivor shqiptar dhe amerikan dëshmon pa ekuivoke se problemet e sigurisë në Shqipëri pas daljes nga Traktati i Varshavës, kishin fituar përparësi ndaj problemeve të tjera. Ndihma ushtarake e Kinës, me gjithë shkëmbimin intensiv të delegacioneve ushtarake ndërmjet të dy vendeve dhe deklaratave të forta të udhëheqjes së lartë kineze në mbrojtje të Shqipërisë, nuk përbënin ndonjë garanci për mbrojtjen e saj. Kina gjendej shumë larg Shqipërisë, dhe efica e ndihmës së saj ishte e diskutueshme. Në analizë të fundit duhet të marrim në konsideratë faktin se kinezët në vitin 1963 e kishin refuzuar një kërkesë të qeverisë

⁴ *Po aty, Spekulative të shtypit mbi afrimin amerikano-shqiptar.* Telegram i Van Heuven i zyrës së Evropës Lindore në D.C. dërguar në Athinë dhe Romë, më 15 nëntor 1972.

⁵ *Po aty, Marrëdhëniet shqiptaro-amerikane.* Telegram i Roxhers drejtuar kryeqyteteve të NATO-s, Sofjes, Hong Kongut, Misionit Amerikan në Kombet e Bashkuara, Misionit Amerikan në NATO në prill 1973.

shqiptare për të përfunduar një aleancë ushtarake me Shqipërinë, pavarësisht nga deklaratat dhe propaganda e qeverisë kineze rreth kësaj çështjeje.

Largimi i Shqipërisë nga Traktati i Varshavës, në mënyrë të njëanshme dhe pa mbushur afatin 20 vjeçar të skadencës së tij, sipas opinionit të një studiuesi amerikan ishte një akt ilegal dhe jo i argumentuar në planin juridik. Gjithashtu koncepti Brezhnevjan i “sovrانيتit të kufizuar” për vendet komuniste të Evropës ishte një argument teorik që mund të përdorej në Shqipëri, pavarësisht nga pretendimet e saj. Në këto rrethana SHBA e ndiqnin me kujdes reagimin e BS dhe aleatëve të tij, si dhe rrezikun e mundshëm të ndonjë sulmi të tyre ndaj Shqipërisë apo edhe Jugosllavisë. Departamenti i Shtetit (DSH) komunikonte dhe informohej rregullisht për sa më sipër sidomos nga Aleanca e Atlantikut të Veriut (NATO) dhe misioni amerikan brenda saj. Më 11 prill 1971, Departamenti i Shtetit udhëzonte Misionin Amerikan pranë NATO-s të diskutonin mbi Shqipërinë, ndonëse ekzistonte opinioni se nuk shihej ndonjë rrezik i mundshëm nga Traktati i Varshavës mbi Shqipërinë. Alarmin e qeverive të Shqipërisë dhe Jugosllavisë për “lëvizje të trupave sovjetike në territorin bullgar”, burimet amerikane nuk e konsideronin të vërtetë⁶.

Pas daljes nga Traktati i Varshavës, qeveria shqiptare u përpoq të përmirësonte marrëdhëniet me fqinjët dhe me vendet e Evropës Perëndimore. Këto lëvizje ndonëse shënonin një farë dalje nga politika e mbylljes, nuk u shoqëruan me ndërprerjen e retorikës kundërkapitaliste, dhe sidomos nuk u frenua propaganda kundër “imperializmit amerikan dhe socialimperializmit sovjetik”. Në nëntor 1971 qeveria shqiptare kishte arritur të vendoste marrëdhënie diplomatike me 50 vende të botës, ndërkohë që në vitin 1966 kishte pasur vetëm 35 të tilla. Në burimet amerikane të dokumentacionit, rivendosja e marrëdhënieve diplomatike me Greqinë në vitin 1971 dhe ngritjen e nivelit të përfaqësimit në rang ambasadorësh me Jugosllavinë, cilësohen si “riparim të gardhit” me fqinjët.

SHBA ushqenin shpresa se përmirësimi i marrëdhënieve kino-amerikane do të reflektohej edhe në marrëdhëniet e tyre me Shqipërinë, por sidoqoftë nuk tregoheshin të sigurt. Dokumentet arkivore amerikane

⁶ *Po aty*. Telegram DSH drejtuar Misionit Amerikan në NATO, më 11 prill 1971.

tregojnë se SHBA kishin informacione për klimën jo gjithnjë të mirë të marrëdhënieve shqiptaro-kineze në vitet 70. Ata ishin në dijeni për reagimin negativ të Shqipërisë ndaj takimit të Çu En Lai me Kosiginin në vitin 1969, për rezervat e tyre ndaj ftesës dhe më vonë vizitës së Niksonit në Kinë (shkurt 1972), për refuzimin e shqiptarëve ndaj propozimeve kineze për të krijuar një aleancë ndërmjet Shqipërisë, Jugosllavisë dhe Rumanisë në Ballkan, për mospjesëmarrjen e delegacionit kinez në kongresin e 6 të PPSH etj.

Dokumentet amerikane që kemi në dispozicion e bëjnë të besueshme idenë se, iniciativa amerikane për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë nuk ishte një akt formal apo thjesht një mënyrë për të matur pulsën e shqiptarëve. SHBA në kërkim të rivendosjes së marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë përdorën edhe kanale jo diplomatike, si: ofertat për shkëmbime shkencore, ekonomike, sportive, kulturore, shtypin, madje paraqitën edhe kërkesa për vizita private me prapavijë politike në Shqipëri. Për realizimin e tyre u aktivizuan sidomos misionet diplomatike në Tiranë, të Italisë, Jugosllavisë, Francës, Greqisë, Turqisë, Austrisë dhe Zvicrës. Këto të fundit i përcollën Departamentit të Shtetit informacione të rëndësishme për Shqipërinë. Veçanërisht aktivë u treguan diplomatët grek, italianë dhe francezë. Ministri i jashtëm grek Pipinelis, duke dashur të kontribuojë në përmirësimin e klimës politike në Ballkan, përdorte si pika referimi objektivat e NATO-s, duke vënë në dukje se objektivi i saj nuk ishte lufta, por shmangia e saj dhe shfrytëzimi i të gjitha mjeteve që sjellin miqësinë.⁷ Sekretari amerikan i Shtetit, Roxhers kërkoi nga Ministria e Jashtme e Greqisë që përmes ambasadorit grek në Tiranë t'i komunikonte dhe t'i bënte të qartë qeverisë shqiptare se SHBA e konsideronin serioz propozimin e tyre për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë, duke i theksuar asaj se "qëndrimi i SHBA nuk është armiqësor dhe se ne mezi presim ditën kur udhëheqësit shqiptarë do ta shqyrtojnë me seriozitet përmirësimin e marrëdhënieve të tyre me Shtetet e Bashkuara."⁸ Për seriozitetin e propozimit amerikan dëshmon gjithashtu një bisedë e zhvilluar më 8 mars 1972 në Departamentin e Shtetit, ndërmjet Richard G. Johnson - drejtor i Çështjeve Ballkanike dhe

⁷ *Po aty*. Nga konferenca e ministrit të Jashtëm të Greqisë, Pipinelis, më 9 maj 1970.

⁸ *Po aty*. Telegram i Roxhers drejtuar ambasadave të SHBA në Romë dhe Beograd, 24 maj 1971.

konsullit italian në Washington, Piero Ferroboshi, e cila iu përcoll ambasadave amerikane në disa kryeqytete evropiane, si dhe Misionit Amerikan në NATO⁹. Duke komentuar politikën amerikane ndaj Shqipërisë Roxhers do të nënvizonte se, SHBA do ta përshëndesnin vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë, por sipas tij mungonte dikush që do të shërbente si katalizator për të nxitur shqiptarët që të ecnin në rrugën e normalizimit. Mungesën e reagimit të shqiptarëve ndaj propozimit amerikan ai e lidhte me stadin e marrëdhënieve amerikano-kineze, të cilat sipas tij ishin në proces evoluimi. Roxhers theksonte se SHBA nuk ndanin të njëjtin mendim me francezët, të cilët mendonin se principet e politikës së jashtme të Shqipërisë përjashtonin mundësinë e normalizimit të marrëdhënieve të saj me SHBA. Më tej, ai bënte të ditur se marrëveshjet bilaterale shqiptaro-amerikane që kishin qenë në fuqi deri në vitin 1939, nuk paraqisnin më për SHBA ndonjë rëndësi substanciale, por Shqipëria duhej t'i shlyente shtetit amerikan rreth 2 milionë dollarë si dëmshpërblime të Luftës së Dytë Botërore dhe 10 milionë \$ të tjera, për të kompensuar vleftën e pronave amerikane, të shtetëzuara nga regjimi komunist në Shqipëri. Sidoqoftë, në Departamentin e Shtetit mendonin se problemet ekonomike do të shqyrtoheshin pas vendosjes së marrëdhënieve diplomatike, në mënyrë që t'i hapnin rrugën këtij procesi. Duke iu referuar kushteve amerikane të vendosura në vitin 1945 për njohjen e qeverisë së atëhershme të Shqipërisë dhe qëndrimit aktual të saj, duket se tashmë (amerikanët) ata kishin "lëshuar terren".

Diplomacia greke u mundua ta shfrytëzojë kërkesën amerikane për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë në optikën e interesave të saj nacionale. Në vitin 1973 Sekretari amerikan i shtetit Roxhers hodhi poshtë disa thashetheme të përhapura nga diplomati grek Kavaljeratos, mbi rolin e ndërmjetësit, që gjoja SHBA i kishte ngarkuar Greqisë, në shpejtimin e këtij procesi. Roxhers i referohej deklaratës së Kavaljeratos, të bërë në një konferencë shtypi në Nikosia të Qipros. Roxhers u tërhoqte vëmendjen disa kryeqyteteve ballkanike, duke u vënë në dukje se Greqia përmes metodave të tilla, donte të mësonte më shumë për këtë çështje, dhe ta shfrytëzonte atë për interesat kombëtare të Greqisë. Kavaljeratos në konferencën e shtypit, përmendi qëllimisht

⁹ *Po aty*. Memorandum bisedimi: *Perspektiva e normalizimit të marrëdhënieve me Shqipërinë*, 8 mars 1972.

rezolutën për “Vorio Epirin”, të miratuar nga senati amerikan në vitin 1946, si pengesë për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike. Me këtë veprim Kavaljeratos donte t’u kujtonte amerikanëve se ky problem ekzistonte ende në marrëdhëniet me Shqipërinë, për të shtuar kreditet personale dhe të forcës politike që ai përfaqësonte, si dhe për t’u kujtuar shqiptarëve vlerat e veçanta të Greqisë në komunitetin e vendeve perëndimore. Problemi i rivendosjes së marrëdhënieve diplomatike të SHBA me Shqipërinë u bë objekt diskutimesh pothuajse në të gjitha vendet ku qeveria shqiptare kishte akredituar misionet e veta diplomatike. Në këtë ndërmarrje u përfshinë edhe Pakistani dhe Meksika. Diplomacia e kësaj të fundit shprehu gatishmërinë e saj për të marrë përsipër rolin e ndërmjetësit në këtë proces.

Disa gazeta të njohura në SHBA si “New York Times” etj, botuan artikuj të posaçëm për marrëdhëniet amerikano-shqiptare në funksion të rivendosjes së marrëdhënieve diplomatike. Gazetari i njohur amerikan Sulzberger, i cili kishte e kishte vizituar Shqipërinë në fund të viteve 50, në vitin 1973 i paraqiti ambasadës shqiptare në Pekin kërkesën për vizë, por ajo u refuzua¹⁰.

Përpjekjet amerikane për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë, tërhoqën vëmendjen e BRSS, i cili nga ana e vet kishte kërkuar në mënyrë të herëpashershme të rivendoste marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë, por ato ishin refuzuar prej qeverive shqiptare.

Një tjetër kanal komunikimi për të prezantuar propozimin amerikan u bë misioni shqiptar pranë Kombeve të Bashkuara në New York. Qeveria amerikane duke filluar që nga viti 1967, i hoqi kufizimet e udhëtimit të shqiptaro-amerikanëve drejt Shqipërisë, katër vjet më parë se këtë të drejtë ta fitonte komuniteti amerikano-kinez në SHBA. Por Misioni Shqiptar në New York dha vetëm një numër të kufizuar vizash për shqiptaro-amerikanët, duke ju përmbajtur kritereve ideologjike. Disa prej intelektualëve të shquar të komunitetit shqiptar në SHBA, si: Nikolla Kosta, Nikolla Pano, Peter Prifti etj., nuk iu dhanë viza, ose ato u lëshuan me shumë vonesë. Nikolla Kosta në shtator 1972, në një takim që pati me disa anëtarë të Misionit shqiptar në New York u përcolli këtyre të fundit mesazhin e Departamentit të Shtetit për të studiuar mundësinë e

¹⁰ *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme (më tej: AMPJ), viti 1973, dos. 512, fl. 75. Njoftim i Behar Shtyllës nga Pekini për MPJ, nr.2778, 24 tetor 1973.*

organizimit të një takimi me një përfaqësues të qeverisë amerikane, me objekt diskutimin e problemit të rivendosjes së marrëdhënieve diplomatike ndërmjet dy vendeve. Kjo skemë ishte përdorur dhe kishte funksionuar më parë me Republikën Popullore të Kinës¹¹. Por propozimi i prof. Kostës ndeshi në refuzimin e plotë të diplomatëve shqiptarë. Nga ana tjetër, komuniteti i shqiptarëve të Amerikës e priti me entuziazëm dhe optimizëm propozimin amerikan. Në rrethet e shqiptarëve të Amerikës qarkullonin zëra se qeveria shqiptare jo vetëm që do ta pranonte propozimin e qeverisë amerikane, por ajo kishte caktuar si ambasador të ardhshëm të Shqipërisë në Uashington, diplomatin Javer Malo. Propozimi amerikan zuri vend në disa artikujt të gazetave kryesore amerikane, në të cilat shprehej mendimi se zhvillimi i marrëdhënieve ndërmjet SHBA dhe Kinës do ta vendoste nën presion udhëheqjen shqiptare, e cila do të ndryshonte mendim ndaj SHBA. Më 30 maj 1973 gazeta “Dielli” botonte një artikull të shqiptaro-amerikanit Hari Stoj, përmes së cilës, në emër të shqiptarëve të Amerikës falënderohej Keneth Rush dhe Departamenti i Shtetit për përpjekjet e bëra për normalizimin e marrëdhënieve me Shqipërinë.

Më 14 janar 1972, kryetari i shoqatës së pingpongistëve amerikanë, Ranford Harrison, paraqiti kërkesën për vizë pranë Misionin Shqiptar në NY. Ai dëshironte të vizitonte në korrik Shqipërinë, pas vizitës që do të bënte më parë në Jugosllavi. Vizita e tij kishte sfond të qartë politik. Një udhëtim të kësaj natyre ai kishte zhvilluar në prill 1971 në RP të Kinës. Është i njohur gjesti sportiv me natyrë politike i pingpongistëve amerikano-kinezë gjatë takimit të zhvilluar në Japoni në prill 1971, i cili ndihmoi sadopak në shkrirjen e akujve dhe u hapi rrugën takimeve të mëvonshme të politikanëve dhe diplomatëve. Të tillë mesazh do të përcillte edhe vizita Harrison në Tiranë. Por kërkesa e tij u la në heshtje. Për udhëheqjen komuniste të Shqipërisë ishte e papranueshme “politika e pingpongut”, si e cilësonte atë Enver Hoxha¹².

Propozime në adresë të qeverisë shqiptare për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike në këtë kohë u bënë edhe nga qeveritë e Britanisë së Madhe, të RFGJ dhe Japonisë. Por përgjigja e udhëheqjes shqiptare në të gjitha rastet ishte negative. Enver Hoxha duke komentuar

¹¹ *Po aty*, viti 1972, dos. 431, fl.25-30. Telegram i Rakos nga New York-u drejtuar MPJ, nr.760, 18 shtator 1972.

¹² Enver Hoxha, *Ditar për Çështje Ndërkombëtare (1970-1971)*, Tiranë 1983, f.337.

këto propozime do të shkruante në ditarin e vet: “Mendoj se nuk kemi pse shpejtohemi të lidhim marrëdhënie me Japoninë. Me Shtetet e Bashkuara të Amerikës jo se jo, por as me Bonin, as me Anglinë. Kjo të na kthejë arin që na ka grabitur, Boni të na paguajë dëmshpërblimet e luftës. Me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ashtu si nuk deshën ata të lidhnin marrëdhënie 30 vjet me radhë, edhe ne nuk duam as për 100 vjet”¹³.

NATO-ja, në mbledhjen e saj të thirrur në Bruksel në maj 1974, diskutoi edhe për Shqipërinë. Anëtarët e NATO-s diskutuan mbi gjendjen e Shqipërisë dhe pozitën e saj strategjike në Mesdhe, duke theksuar se politika e saj e asnjansisë nga dy blloqet ushtarake, ishte disi në favorin e NATO-s, pasi BRSS nuk kishin ndonjë bazë të tillë në këtë rajon, ashtu si NATO. Situata u gjykua e tillë që nuk duhej të krijoheshin acarime me Shqipërinë, por duheshin përmirësuar marrëdhëniet me të. Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Anglia duhej të vazhdonin të përpiqeshin të lidhnin marrëdhënie diplomatike me Shqipërinë, por pa u nxituar. Italia u vlerësua si vendi përfundimor më i përshtatshëm, që mund të komunikonte me shqiptarët. Duke iu referuar asaj situatë, Enver Hoxha do të shkruante në ditarin e vet: “Moska u lodh për të rivendosur marrëdhënie diplomatike me ne; Uashingtoni, dhe ky i pari bëri avanca po në këtë drejtim, dhe u ndoq pastaj nga Anglia. Ne bëjmë, me të drejtë, veshin e shurdhër. Politika jonë është po aq kundër dhe e vendosur edhe kundër imperialistëve amerikanë në Mesdhe, por NATO-ja mendon se rreziku nuk i vjen nga Shqipëria, po nga sovjetikët”¹⁴. Një përgjigje ndaj propozimit amerikan për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë, Enver Hoxha e dha më 3 tetor 1974, në fjalimin e mbajtur me zgjedhësit e zonës elektorale 208, në Tiranë. Ai e refuzoi propozimin amerikan duke e artikuluar atë me tone mburrjeje dhe aspak diplomatike¹⁵.

Sidoqoftë përpjekjet e SHBA për të rivendosur marrëdhëniet diplomatike me Shqipërinë vazhduan edhe më mbrapa, por kjo çështje erdhi duke u zbehur. Shqipëria humbi një shans, duke vazhduar më tej rrugën e refuzimeve për pjesëmarrje në Konferencën e Helsinkit dhe në iniciativa të tjera me karakter rajonal, evropian dhe botëror.

¹³ *Po aty*, f.454, 23 prill 1973.

¹⁴ *Po aty*, f.480-481, 4 qershor 1973.

¹⁵ “Zëri i Popullit”, 4 tetor 1974.

